

**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 987/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) paraqitur kundër Goran Rakiq, për shkak të transportimit të qytetarëve për të votuar, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 01.12.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë.

**Arsyetim**

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), në të cilën pretendohet se më datë 01.12.2013, në Mitrovicën e Veriut, në shkollën Teknike numër 3805x, Goran Rakiq ka transportuar qytetarë nga Kraveva dhe Çaçaku të Serbisë për të votuar në këtë qendër, Parashtruesi i ankesës potencion se të njëjtit kanë qenë të pajisur me dokumente të falsifikuara dhe personi në fjalë ka qëndruar tërë ditën në këtë qendër të votimit dhe ka ushtruar presion të vazhdueshëm tek votuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**


Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se më datë 01.12.2013 se në shkollën teknike me nr të vendvotimit 3805x në Mitrovicën e Veriut, Goran Rakiq ka transportuar qytetarë nga Kraleva dhe Çaçaku, të Serbisë, PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se nuk është ofruar dëshmi nga pala ankuese për të identifikuar autorin dhe për të vërtetuar shkeljen e supozuar. PZAP-i, vlerëson se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 987/2013 më datën 04.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.